



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

## NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE NË ZBATIM TË CENS-IT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Në zbatim të ligjit Nr 17/2018, datë 08.05.2018 “Për Statistikat Zyrtare “, Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Dokumentin e Srtategjisë dhe Planifikimit të CENS-it 2020, si dhe në Kontratën e Grantit direkt për projektin “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020” me Nr.1817Prot, datë 11.12.2018 lidhur ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e Bashkimit Evropian dhe Bankes Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë INSTAT, shpall procedurat e rekrutimit për vendet e lira si më poshtë vijon:

- Koordinator Teknik për CENS-in e popullsisë dhe Banesave 2020 (1 pozicion)

**Afati i dorëzimit të dokumentacionit për të gjithë aplikantët do të jetë data 11/02/2019.**

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a -Kërkesë për pozicionin
- b-Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 11/02/2019** pranë Drejtorisë të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ne INSTAT.

Në datën **18/02/2019**, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse do të shpallë në faqen e internetit të Institutit të Statistikave listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e rekrutimit, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista/testim/konkurs.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042233356, ose në adresën: Instituti i Statistikave, Bulevardi: “Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017Tiranë, SHQIPËRI”.

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,  
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

**[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)**